



5 Martesa në Zvicër

Qëllimi: Për personat të cilët dëshirojnë të lidhin kurorë në Zvicër me një shtetas zviceran apo me një të huaj që jeton në Zvicër me leje qëndrim të përkohshëm ose të përhershëm.

Ju lusim të mos vonoheni në ditën e terminit. Nëse arrini me vonesë, ju duhet të caktoni termin të ri.

Ta keni parasysh se:

- Asnjë dokument nuk duhet të dërgohet drejtpërdrejt në ambasadë.
- Ju duhet t'i sillni dokumentet personalisht në ditën kur ju është caktuar termini.
- Dosjet e pakompletuara nuk pranohen.

► Dokumentet e nevojshme:

Partneri, i cili jeton në Maqedoni duhet t'i dorëzojë këto dokumente në Ambasadën Zvicerane:

- 3 formularë të plotësuar dhe të nënshkruar si dhe 4 fotografi pasaporte.
- Formulari "Kërkesë për përgatitje për martesë". Ky formular duhet të plotësohet paraprakisht (pa datë, pa nënshkrim).
- Dokumenti i vlefshëm i udhëtimit si dhe 4 kopje.
- 4 kopje të pasaportës dhe të leje qëndrimit së bashkëshortit/-es në Zvicër.
- Dokumenti origjinal "Certifikatë e lindjes" lëshuar nga autoriteti kompetent ku ka ndodhur lindja.
- Dokumenti origjinal "Certifikate e vendbanimit". Vërtetim origjinal për të gjitha ndryshimet në librin e amzës:
Gjendja civile "beqar" përshkruhet në vërtetim me: "Nuk ka shënime".
Gjendja civile "i martuar" përshkruhet në vërtetim me: "...ka lidhur kurorë me...në..." dhe "Nuk ka shënime tjera".
Gjendja civile "i shkurorëzuar" përshkruhet në vërtetim me "Ka qene i martuar me ... me daten në ...", "Martesa me ...eshte shkurorëzuar me vendim të gjykatën me daten ..." et "Nuk ka shënime tjera"
- Formulari "Pyetje shtesë lidhur me bashkimin familjar", i nënshkruar nga partneri i cili jeton në Zvicër.
- 2 kopje të pasaportës së bashkëshortit/-es në Zvicër + 2 kopje e lejëqendrimit të tij/saj.
- Vërtetim origjinal nga ana e Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe nga ana e gjykatës se personi nuk është nën hetime.
- Për personat të cilët janë të shkurorëzuar: kopja e verifikuar e fletëshkurorëzimit (me shënim rreth plotfuqishmërisë) si dhe certifikata e martesës së mëparshme, me vërejtje se martesa është e ndërprerë.
- Për personat të cilët janë të ve: certifikata origjinale e vdekjes e bashkëshortit/-es paraprak/-e, e lëshuar nga shteti i vdekjes si dhe certifikata origjinale e martesës, me vërejtje se martesa është e ndërprerë.
- Në rast të ndryshimit të emrit: Kopje e vërtetuar e aktgjykimit të ndryshimit të emrit.
- Nëse keni lindur jashtë martesës: Vendimi i gjykatës për pranimin e atësisë .*
- Nëse keni fëmijë të përbashkët: Certifikata origjinale e lindjes së fëmijës, e lëshuar nga shteti i lindjes, ku shkruan emri i dy prindërve.

INFORMATA TË RENDËSISHME:

- **Të gjitha** dokumentet duhet të jenë me nga një kopje shtesë.
- * Të gjitha vendimet të cilat janë në gjuhë lokale duhet të përkthehen në njërën prej gjuhëve zyrtare të Zvicrës.
- Gjithë dokumentet e gjendjes civile nuk duhet të jenë më të vjetra se 6 muaj.
- Partneri në Zvicër duhet të interesohet në Qendrën e Statusit Civil përkatës për hapat e mëtutjeshëm.
- Për aplikim në Kosovë nuk është e nevojshme prania e partnerit i cili banon në Zvicër.
- Formularët merren falas në sportelin e Ambasadës Zvicerane.

Të gjitha dokumentet kosovare duhet ta kenë vulën apostile qoftë të Ministrisë së Punëve të Jashtme ose të Ministrisë së Punëve të Brendshme të Kosovës varësisht nga dokumenti/certifikata. Në faqen 3 mund ta gjeni një shembull.



Informata të përgjithshme:

- Vetëm personat me termin të caktuar i lejohet hyrja tek sporteli.
- Vendimet merren vetëm nga autoritetet e kantonit apo të shtetit federal në Zvicër.
- Për informata shtesë: www.eda.admin.ch/westbalkan

Si caktohet termini:

- **Caktimi i terminit:** Ju lusim ta kontaktoni ambasadën tonë përmes e-mailit për të caktuar termin: pri.visa@eda.admin.ch. Ju lutëm të bashkëngjiti **një kopje të skanuar dhe të lexueshme të pasaportës të secilit person që dëshiron të bëjë kërkesë për martesë në Kosovë.**
- **Dorëzimi i dokumenteve :** Përbajuni udhëzimeve në lidhje me terminin dhe siguroni të gjitha dokumentet e nevojshme. Ejani në ambasadë në ditën dhe kohën e terminit tuaj.
- **Marrja e vendimit :** Vendimi për vizë merret nga autoritetet kompetente në Zvicër Bashkëshorti/ja – prindi në Zvicër do të informohet me shkrim. Kur merrni vendimin, ju lusim që të vini me kopjen e vendimit dhe pasaportën tuaj prej të hënës deri të premtën prej orës 8.00 deri në orën 9:45 në Ambasadë.

Terminët caktohen në mënyre kronologjike dhe janë pa pagesë (nuk ka terminë me prioritet)

Orari i punës i sektorit konsullor:

Dorëzimi i aplikimit:

vetëm me termin

e hënë - e premtë

Pagesat për aplikim të vizave:

Shpenzimet për procedurën në Prishtinë janë 203€+ 60€tarifa e vizës.

- Për çdo pagesë që e bëni ju takon një fletëpagesë e nënshkruar.
- Pagesa duhet të bëhet në Euro.
- Pagesa bëhet vetëm tek sporteli brenda ambasadës (ndërtesa brenda rrethojave të zeza).
- Tarifat në lidhje me shërbimet konsullore janë llogaritur në bazë të rregullores RS 191.11.
- Tarifat në lidhje me aplikimet për vizë janë llogaritur në bazë të rregullores RS 142.209.
- Varësisht prej rastit: Pagesë shtesë administrate.
- Paratë e pagesës nuk kthehen (edhe në rast se viza refuzohet).

Kuides nga Agjencitë

- Gjithë ata që ofrojnë shërbime jashtë rrethojave të zeza nuk i përkasin stafit të ambasadës.
- Ambasada Zvicerane nuk bashkëpunon me asnjë agjenci jashtë ndërtesës së vet.
- Stafi i Ambasadës Zvicerane nuk ka kontakt me agjencitë jashtë ndërtesës.
- Ambasada Zvicerane gjendet në hapësirat e kufizuara me rrethoja të zeza.
- Ambasada Zvicerane i jep formularët pa pagesë.
- Ambasada Zvicerane jep informata pa pagesë.
- Ambasada Zvicerane nuk rekomandon asnjë kompani të sigurimeve.

Kini parasysh se Ambasada Zvicerane:

- Nuk pranon aplikim pa termin të caktuar.
- Nuk jep informata përmes telefonit apo emailit në lidhje me aplikimet për vizë në pritje.
- Ka të drejtë:
 - ° të kërkojë dokumente shtesë.
 - ° ti dërgojë aplikimet për vendim apo miratim tek autoritetet në Zvicër.
 - ° t'i thërrasë aplikuesit në bisedë ose intervistë.
 - ° ta ndryshojë këtë rregullore pa një njoftim paraprak.